

**P R O F I L I
I K O M U N Ě S
S Ě L I K O V Ě S**

1.HISTORIA E KOMUNËS

Hulumtimet e shumta shkencore të deritashme kanë treguar se vendbanimet e komunës së Likovës kanë qenë të formuar shumë vite para erës sonë , gjatë kohës së ilirëve . Janë parashtruar shumë hipoteza se toponimet janë shfrytëzuar gjatë kohës së Dardanëve dhe Peonëve . Këtë vërtetojnë gropimet e ndryshme të argjilit dhe materialet tjera na lokalitetin Drezga – Llopat dhe rimnik -Mateç . Vërtetim i madh për atë është edhe bunari ekzistues nga koha e romakëve , si dhe gropimi i dy arkivoleve në kohën e ndërtimit të liqenit artificial të Likovës prej vitit 1951 deri 1958 . Prej 1389 deri 1912 rajoni i Likovës i ka takuar peandorisë së Turqisë . Për këtë ka të shkruar të dhëna në tefteret e Turqisë për grumbullimin e taksave „Staro Nagoriçane Nahija “prej 1519 .

Në vitin 1919 disa fshatra nga rajoni i Likovës kanë qenë të organizuar në komunë Hotlës , e cila ka numëruar 5400 banorë .Këtë lloj të organizimit të jetës komuanle në këtë rajon e vërtetojnë edhe shumë udhëpërshkrime,gjeografi, demografi dhe punëtor tjerë shkencor . Hulumtimet më të reja shkencore gjeografike për rajonin e Likovës i kë bërë Prof.D-r. Asllan Selmani .

Në përbërjen e Republikës Federative të Jugosllavisë është formuar komuna e LIKOVËS më vitin1955 dhe është shpërbërë më 1965 . Pas pavarësisë të Republikës së Maqedonisë , me kërkesë të vet qytetarëve përsëri formohet komuna e Likovës .

2.PËRSHKRIMI GJEOGRAFIK

Komuna e sotit e LIKOVËS hynë në grupin e komunave rurale të mesme të vogla të Republikës së Maqedonisë dhe gjendet në pjesën veriore të saj .Pjesa më e madhe e territorit i takon rajoneve të lumit të Likovës , pastaj lumit të Llojanit dhe Vaksincës . Territori i komunës së Likovës e ka formën e trekëndëshit të barabartë të kthyer prap dhe drejtimi i shtrirjes veri-jug .Në veri kufizohet me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Sërbisë , në lindje me komunën e Kumanovës , në jug me komunën e Haraçinës , kurse në perëndim me komunën e Gazi Babës dhe Çuçer- Sandevës .

Vendbanimet fushore janë të lidhura kryesisht me rrugë me asfalt , e me arterie kryesore të rrugës në relacionin Likovë-Kumanovë , me të cilën janë lidhura rrugët të tjera . Në vitin 2000 është ndërtuar drejtimi rrugor Vaksincë –Sllupçan , Sllupçan – Orizare dhe Mateç –Nikushtak .

Këtu gjenden 22 vendbanime që shtrihen në lartësi mbidetare prej 365 m, çka është nën mesataren për shtetin . Më të larta janë Strazha dhe Strima me 1.050 m , kurse më të ulta janë Opaja , Orizarja , Sllupçani etj . Këtu jetojnë gjithsej 27.058 banorë ose 103,03 në një km² , çka është larg nga mesatarja e shtetit . Për dallim prej 1994 numri i banorëve është rritur për 4.224 banorë ose për 18,50% në vendbanimin qendror të Likovës jetojnë 2.644 banorë ose 11,60% nga numri i përgjithshëm në komunë. Vendbanime më të mëdha se vendbanimi qendror janë : Mateçi , Sllupçani, Hotla dhe Llojani .Në relacion me përkatësinë etnike në këtë komunë jetojnë kryesisht shqiptarë nga nacionalitetet tjera çka jetojnë në shtet janë evidentuar :

1.Gazeta zyrtare – Shkup nr.20/55

2.Gazeta zyrtare- Shkup prej 25.01.1965 .

3.gazeta zyrtare –shkup nr.49/06 .

169 maqedon , kryesisht në fshatin Opajë , pastaj një vllah , 370 sërbi , prej të cilëve 325 në Mateç , 6 bashnjak dhe 152 tjerë me përkatësi tjetër etnike , të cilët pas konfliktit luftarak të 2001 nuk janë kthyer në vendet e tyre . Banorët janë të vendosur në 5.340 ose në çdo familje (amvisëri) jetojnë nga 4.67 persona .Numri i amvisërive është 5.340 ose në çdo amvisëri jetojnë mesatarisht 5.07 anëtarë . Kjo tregon relativisht një pozitë të papërshtatshme të popullatës , sipas standardeve bashkëkohore të jetesës .

Në lidhje me strukturat agrare , dominojnë pyjet me 9.668 ha , tokë punuese në 8.256 ha , kurse kullosa na 4.375 ha .

Njëra nga shenjat kryesore të kësaj hapësire janë liqejt artificial atraktiv të Likovës dhe Gllazhnjës . I pari është akumuluar në lumin e Likovës , në afërsi të drejtpërdrejt të fsh.Likovë . Është ndërtuar më 1958 në sipërfaqen prej 0,40 km² , e në të janë akumuluar 2.250.000 km³ ujë . Përveç për ujitje shërben edhe për amvisëri për qytetarët e komunës së Kumanovës . Për qytetarët shërben si vend peshkimi për numër të madhë të peshkatarëve të qytetit dhe Shkupit . Mes lumit gjendet edhe një liqej , nga ky më i madh që quhet liqeu i Gllazhnjës . Nga Kumanovë ai është i larguar 15 km , kurse emrin e ka fituar sipas fshatit çka është më afër . I vendosur në rrëzat veri-lindje të Malit të Zi të Shkupit , ky grumbullon 22.000.000 m³ ujë . Sipërfaqja është 1km² e është ndërtuar më vitin 1973 . Edhe ky liqej , si ai paraprak , paraqet vend të peshkimit shumë të përshtatshëm me lloje të ndryshme të peshqive : pastërmka e lumit , krapi , karas , kleni , belvica etj .

Harta e komunës së Likovës faqa 27 dhe 28 të ZHEL .

2.1. ATRAKCIONET ARKIOLOGJIKE HISTORIKE

Nga përmendoret kulturore historike do ta përmendim manastirin Shën Marija (Sveta Bogodorica) në kadastrën komunale të Mateçit. I ndërtuar në vendin e dikurshëm të ujit të shenjt ku kanë punuar dy nadržlekar. Ndërtimi ka filluar me sasi të madhe të arit e ka ndihmuar edhe Sulltan Murati 1, kur ka kaluar nëpër Malin e Zi të Shkupit në rrugë për në Kosovë në vitin 1389.

Nga objektet sakramentale tjera do ta përmendim teqen e vjetër në Mateç dhe xhamitë të cilat u dëmtuan e pastaj u rrenvuan, pas konfliktit luftarak në vitin 2001.

Sipas organizim më të ri territorial komuna nuk ka pësuar ndryshime.

3. PËRBËRJA GJEOLOGJIKE DHE E RELIEVIT

Territori i komunës së Likovës karakterizohet me përbërje të ndryshme arkiologjike dhe strukturë shumë të ndërlikuar tektonike. Në hapëisrat e tij paraqitet lloje të ndryshme të fundrrinave, shkëmbinjë metamorf dhe magmatik të cilët kanë formën poleozoike, mezoike dhe terciare –kuartare.

Shkëmbinjët në këtë hapësirë janë ndërtuar nga gur gëlqeror të kristalizuar, granit dhe mermer nga „Serija e Velesit“ Metamorfniot kompleks të kësaj serije dhe shumë e ndërlikuar dhe karakterizohet me dallime litologjike dhe me thyerje të ndryshme të komplekseve tektonike.

Mermeri në këtë rajon lajmërohet në shumë zona dhe në forma të ndryshme, para se gjithash në rrethinën e Llojanit, Nikushtakut dhe në lokacionet tjera. Ato i takojnë grupit të shkëmbinjëve nga „Serija e Velesit“ me formë të pllakës dhe me masovitet të dukshëm, e janë në lidhje të ngushtë me kuarцитët. Masa e serpentines rreth Llojanit paraqitet masa e zgjatur, me drejtim të shtrirjes në veriperëndim, të krijuar nga periudha e jurës. Në rrethinën e fshatit Sllupçan paraqitet seria e graniteve, dijabazit dhe gabrodioriteve.

Sedimentet kvartare janë të paraqitura me shkëmbinjë me rërë, konglomerate, sedimente aluvijale dhe tjera. Pjesa më e madhe e këtyre sedimenteve në zonën në dalje të lumejve nga kompleksi malor. Këto lloj sedimente kanë shtrirje të gjërë në shtartin e lumit të Llojanit, lumi e Thatë, lumi i Sllupçanit etj. ku përshkak të shirave të fortë paraqitet degradimi i tokës bujqësore nga materiali i bartur.

Masa e serpentines në Llojan paraqet një tërësi me shumë kultura, të ndara nga më shumë masa me drejtim të shtrirjes nga veri-lindja, në lloj të thjerrzave serpentine të shtrënguara në shkëmbinjë nga graniti, plagjigraniti dhe sienet, si dhe dijabazi formacioni nga koha e jurës dhe tjera.

Nga paraqitjet e xeheve në Llojan me rëndësi është antimoni dhe arseni në reolitet dhe serpentinet afër fshatit në sinorin e fshatit Llojan, kurse në sinorin e fshatit Nikushtak paraqitet Antimoni dhe Nikeli. Xehet kryesore janë Antimoni dhe Realgari me 6,50% As dhe 4% Sb.

Komuna e Likovës është e ndarë dhe është teracë abrazive me lartësi prej 365-480 m. Këto teraca të frytshme aluvijale krijojnë kushte më të përshtatshme për bujqësi më të mirë, e cila është nën sistem 60%, veçanarisht për kultivimin e kulturave të dobishme. duhani, gruri, misër, elbi, perime, pemë, dhe vreshta.

3.1. Releivi

Topografikisht , komuna e Likovës gjendet në hapësirën ku bashkohet lugina (pjesa e poshtme) dhe kodrat (pjesa kodrinore) nga liqeu i Likovës dhe Gllazhnjës .

Relieve malor në komunë është i paraqitur përmes maleve në sinorin e fshatit Mateç (Vuksani , Smilovica, Ostrec etj) fshati Likovë , fshati Goshincë (Kupilaqa) etj , ato janë të begatshme me kullosa dhe pyje , veçanarisht fletat që bien , por janë pak me popullat dhe nuk janë të zhvilluara .

Relievin malor të komunës e përbënë terreni me lartësi mbidetare prej 580-1050 m .

Relievin fushor të komunës e përbënë terreni me lartësi mbidetare prej 365 – 480 m .

4.KUSHTET KLIMATIKE

Klima në komunën e Likovës është nën ndikimin e fortë të masave të ftohta të ajrit që fryejnë nga veriu , posaçërisht gjatë kohës së dimrit .Këto masa ndikojnë për zvogëlimin e temperaturave të ajrit . Nga ana tjetër përmes luginës të lumit Vardar hyjnë ndikimet e mediteranit nga veriu , për çka tregojnë bimët tipike të mediteranit .

Duke marrë parasysh faktin se në komunë nuk ekziston stacion meteorologjik , të dhënat për temperaturat janë marrë në bazë të dhënave të stacionit në Kumanovë dhe Shkup . Muaji më i ftohtë është janari me 0,4 C . Temperatura më e ulët në këtë rajon janë vërejtur më 27.01.1954 edhe atë -24,0 C . Këto temperature të ulta ndikojnë mbi mjedisin jetësor dhe veçanarisht ndaj bujqësisë .

Faqa 30 nga PAEL(LEAP).

Sasia vjetore e të reshuarve në regjionin e Likovës është 549,2 mm , gjegjësisht kjo hapësirë pranon sasi më të madhe të të reshurave nga fushëgropa e Shkupit , por shumë më pak nga Krivo Palanka . Sezonat me të reshura më të shumta janë pranvera dhe vjeshtë , me mesatare më të madhe është muaji maj (72,1mm). Kundër kësaj , sezona e verës është shumë e thatë , mesatarja e të reshurave në muajin gusht ,vetëm 30,2 mm .

5. RESURSET NATYRORE

5.1. Toka –karakteristikat ekonomike

Komuna e Likovës bie në grupën e rajoneve të pazhvilluara dhe praktikisht në territorin e saj nuk ekziston asnjë objekt industrial . Veprimtaria kryesore ekonomike është bujqësia , ku është angazhuar 95% nga popullata aktive . Bujqësia praktikohet në sipërfaqe prej 22.599 ha , nga të cilat 8.256 ha ose 36,50 % është tokë punuese , e cila pjesërisht ujitet nga hidrosistemi i Likovës . Kullosat përfshijnë 4.375 ha ose 19,30% , kurse pyjet janë më të shpërndara në sipërfaqe prej 9.968 ha ose 44,20% .

Mbisundon prodhimi tradicional bujqësor , kryesisht kulturat e drithnajave dhe diçka perimet për nevojat e tyre dhe për tregjet që janë më afër në Kumanovë dhe Shkup. Sipërfaqet bujqësore janë parcelizuar në të cilën kultivohen monokulturat .

Blegtoria para njëzet viteve ka qenë veprimtari atraktive , kurse sot delet janë paraqitje shumë e rrallë . Kryesisht ruhen lopët që lëshojnë qumsht për nevojat shtëpiak e kurse tri fermat e lopëve , secila me nga 30 lopë , janë shkatërruar gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001 . Sipas disa të dhënave të caktuara , në atë kohë kanë humbur mbi 3500 lopë .

Sektori privat ka angazhuar një numër të vogël të njerëzve , kryesisht në tregti dhe disa shoqata të vogla për prodhimin e tullave të çimentos , bekatonkave dhe mullinjëve (Opajë , Sllupçan , Likovë dhe Ropalcë) .

Në komunë nuk ka kushte për punësimin e popullatës aktive , për çka mbi 2500 vetë të evidentuar si të papunësuar dhe një numër i vogël i tyre merrë ndihmë sociale . Rreth 50 persona janë të punësuar në administratën publike dhe ndërmarrjet publike dhe 30 të punësuar në administratën komunale dhe disa ndërmarrje private .

Urbanizimi në komunën e Likovës , kanë plane të përgjithshme urbanistike fshatrat : Llojanë , Vaksincë , Sllupçan , Opajë , Orizare , Likovë , Hotël , Mateç , Ropalcë , Vishticë dhe Nikushtak .

Edhe pse ekzistojnë kushte për zhvillim të turizmit , aspak nuk janë shfrytëzuar mundësitë të dy hidroakumulacioneve të Likovës dhe Gllazhnjës , kurse nga njëher në këtë funksion përdoret manastiri –pushimorja në fshatin Mateç deri më vitin 2001 .

Edhe pse nuk ekzistojnë objekte industriale , rajoni i komunës së Likovës prap mund të karakterizohet si mjedis i ndotur . Pika ekocile serioze paraqesin koncentrimin e arsenit , kromit dhe antimonit , nga deponija e lëshuar e Llojanit , pastaj pluhuri nga gurëthyesi në fshatin Orizare , Likovë dhe Hotël , si dhe pluhuri nga mosasfaltimi i rrugëve të fshatrave , veçanarisht gjatë kohës së verës . Koncentratet nga shtresa e arsenit, antimonit dhe kromit në minierë , veçanarisht i ndotë ujërat nëntokësor të fshatrave në fshatin Vaksincë dhe Llojan.

Faqa 37 nga PAEL(LEAP)

5.2 HIDROGRAFIA

Rajoni i kësaj komune i takon vedgrumbullimit të lumit të Likovës dhe lumit të Llojanit , të cilët derdhen në lumin e Tabanocës , e kjo derdhet në lumin e Pçinjës . Në lumin e Likovës ekzistojnë dy liqejë akumulativ , i Likovës dhe i Gllazhnjës .

Vendgrumbullimi i lumit të Likovës është një nga vendgrumbullimet më të mëdha në rajonin e Likovës - Karadakut dhe Malit të Zi të Shkupit . Është i formuar nga shumë lumejë , përrocka dhe rrjedhje të ujërave të përkohshëm . Ujërat në vendgrumbullimin e lartë grumbullohen në Kamena . Mulliri dhe lumi i Dumanocës , të cilat te fshati Gllazhnje grumbullohen dhe e japin lumin e Likovës . Deri te dalja në fushat e Likovës ka karakter të një gryke të malit, me prerje të thellë dhe anë të ngushta . Pas daljes në fushën e Likovës i grumbullon lumi i Strimës dhe Vuksanit , si dhe ujërat e lumit të Sllupçanit .

Lumi i Sllupçanit e cila është e përbërë nga lumi i vogël dhe i madhë ka derdhje të veçantë dhe derdhet në lumin e Tabanocës . Ka ramje të pjerrët në maje të lumit nga fusha e Llojanit , e përshkak shtratit të granitit – dijabasko ka jashtëzakonishtë ujë të pastër deri në fshatin Llojan . Ky lum është i përshtatshëm për ndërtimin e një akumulacioni të vogël për furnizim me ujë dhe ujitjen e sipërfaqeve bujqësore për çka është punuar edhe projekti teknik .

5.3 Minerale

Komuna e Likovës disponon me antimon dhe arsen nga miniera e Llojanit dhe mermer dhe granit të cilin e ka shfrytëzuar Sileksi i Kratovës nga vendbanimet e Mateçit dhe Nikushtakut .

5.4. Karakteristikat biografike

Në rajonin e komunës së Likovës dominon vegetacioni i barit dhe i pyjeve në krahasim me pjesën tjetër të mbetur në pjesën më të madhe të rajonit të Likovës , me lloj-lloj bashkësi të pyjeve .

Pyjet prej shpardhe dhe shkoza e bardhë takohen në lloj të shiritit anësh në luginën e Likovës rreth 800 metra lartësi mbidetare , duke hyrë nga të dyja anëve nga gryka e lumit të të Likovës , deri në fshatin Dumanocë . Bashkësia është termokserofile me dominim të shpardhëz i shoqëruar me me shkozë të bardhë në sipërfaqe të vogël në 700mnv , takohet bashkësia të kalaveshit të shkembës e cila është njësoj e degraduar me paraqitjen e shpardhëz , shkozës së bardhë , shkembës së zezë , kurse në katin përdhësë edhe kullosat kserofile etj.

Pyjet e lajthive të egra dhe shkozës së zezë takohet te fshati Bellanocë (1950-1137mnv) . rritet në terren gëlqeror , me dominim të shkozës së zezë .

Pyjet nga dushku shpatuk dhe qarri takohen në sipërfaqe të vogla rreth malit të fshatit Dumanocë dhe fshatit Hotël . Pyjet nga goruni takohen në më shumë vende në rajonin e Likovës –Karadakut .

Bota shtazore është e llojllojshme dhe përsëri gjuajtjes intenzive të egërsirave , në këto pjesë takohet ariu , dhelpra , ujku , lepuri , zogjë të ndryshëm (rreth 180 llojeve) , lloje të ndryshme të zvarranikëve etj.

6. Popullata dhe vendbanimet

Të dhënat e para për popullatën në rajonin e komunës së Likovës datojnë nga fillimi i shekullit 20 , të grumbulluara nga udhëpërshkrimet , mësuesit , si dhe regjistrimet të pushtetarëve të atëhershëm . Sipas atyre të dhënave më vitin 1990 kanë jetuar gjithsej

14.678 banorë , më 1913 ka pasë 11.453 banorë , e më 1921 ka pasur 12.234 banorë e më 1931 13.450 banorë .

Faqa 33 nga PAEL (LEAP)

Në luftën e dytë botërore më vitin 1948 është bërë regjistrimi i parë zyrtarë të popullatës . Ai tregon se në rajonin e komunës së sotme të Likovës kanë jetuar gjithsej 18.135 banorë . Më vitin 1971 numri i banorëve është rritur në 20.899 banorë , kurse më 1994 22.861 banorë .

Në periudhën prej 1948 deri më 1971 numri i banorëve shënon lëvizje pozitive prej 2.764 banorë ose për 13% , derisa në periudhën e ardhshme prej 1971 deri 1994 rritja e banorëve është 1.962 banorë ose për 8.5% .

Migjithatë në vendbanimet malore në periudhë 1971 deri 1994 numri i banorëve është zvogëluar dukshëm , si në Allashec për 52,7% , Bellanocë deri më 95,0%, Glazhnje për 69,9% , Dumanocë për 98,6% , Zllakuçan për 63,4% , Izvor 89,8% , Orkocë 82,6% , Runicë 74,2% dhe Strimë për 67,9% .Popullata , kryesisht, është shpërngulur në vendet e rrafshita të këtij rajoni , por edhe në qytetin e Kumanovës dhe Shkupit , si dhe në Turqi . Vetëm se në periudhën 1953-1966 rreth 4.450 banorë kanë emigruar për në Turqi .

Në vendbanimet e fushore të cilat karakterizohen me kushte më të mira për jetë , numri i banorëve është rritur në mënyrë natyrore dhe vërshim mekanik . Në periudhën 1971 -1994 veçanarishtë rritja e banorëve paraqitet në fshatin Hotël për 82,6% , Likovë 51% , Orizare 44,1% , Vaksincë 37,9% , Sllupçan 38,1% , Ropalcë 30.1% dhe Llojan 27,5% .

Faqa 34 nga PAEL (LEAP)

Dendësia mesatare e popullatës është 110 banorë në 1km² . Ajo është më e lartë në vendbanimet fushore , për dallim nga vendbanimet kodrinoro-malore të cilat kanë sinor më të madhë , por numër më të vogël të banorëve (Dumanocë,Allashec,Goshincë, Strimë , Orkocë etj.) . Fshati Strazhë është i vetmi vendbanim i cili është shpërngulur qysh prej vitit 1978 . Në rajonin e komunës nuk ka vendbanim qyteti .

Qendra administrative e komunës është në fshatin Likovë me 2644 banorë , ndaj të cilit gravitojnë vendbanime tjera të fshatrave . Vendbanimi më i madhë është fshati Slupcanë , me 3789 banorë.

Vendbanime	Lartësia mbidetare në metra	Sipërf.e sinorit në km2	1948	1971	1981	1991	1994	2002
Likovë	420	13,4	1418	1542		/	2331	2644
Allashecë	450	27,7	496	334		/	158	126
Bellanocë	940	9,4	407	241		/	11	7
Vaksincë	480	17,5	1024	1627		/	2242	2479
Vishticë	580	6,8	553	732		/	938	991
Gllazhnje	560	10,5	482	252		/	76	54
Goshincë	910-1040	12,9	631	512		/	643	424
Dumanovc	580	13,0	477	605		/	14	0
Zllakuçani	820	2,2	163	71		/	29	12
Izvori	810	5,8	304	293		/	30	4
Llojani	440	18,6	943	1784		/	2267	2682
Mateçi	480	34,1	2657	2616		/	3126	3394
Nikushtaku	500-590	20,4	1331	1411		/	163	1748
Opajë	365	3,3	1123	1684		/	1880	1996
Orizare	400	4,9	817	1282		/	1841	2096
Hotël	500	17,1	1543	1638		/	2677	3148
Orkocë	780	2,8	213	201		/	35	21
Ropalcë	460	4,9	516	815		/	1085	1373
Runicë	600	13,0	654	705		/	181	69
Sllupçan	415	16,8	1571	2249		/	3037	3789
Strimë	1050	8,5	365	305		/	98	3
Strazhë	1020	7,0	447	0		/	0	0
Gjithsej:	xxx	270,6	18.135	20.899		/	22.861	27058

Sipas përbërjes nacionale pjesa më të madhe të popullatës e përbëjnë shqiptarët 96,13% dhe sërëbët 1,77% , ndërsa numri i bashkësive tjera të mbetura është i parëndësishëm . Në secilën nga gjithsej 3.599 familje në komunë jetojnë në mesatare prej 6,4 anëtarë . Meshkujtë janë me numër më të madhë nga femrat , me 52:48 .

Komuna e Likovës sipas regjistrimeve e ka këtë strukturë të popullatës (në vitin 1991 është bojkotuar regjistrimi nga popullata shqiptare) . Burimet e të dhënave : Enti shtetwror për statistik në RM .

Komuna e Likovës sipas regjistrimit të vitit 2002 e ka këtë strukturë të popullatës :

Amvisëri	Shtëpi	Gjithsej popullatë
5340	5790	27058

Gjinia	Deri 4 vite	5-15 v.	15-65 v.	Mbi 65 v.	Gjithsej
Mashkuj					13701

Femra					13348
Gjithsej					27058

a). Moshë dhe struktura gjinore e popullatës sipas regjistrimit të popullatës të RM prej vitit 2002

Shqiptarë	Maqedon	Sërb	Vlleh	Boshnjak	Të tjerë	Gjithsej
26360	169	370	1	6	152	27058

b). Gjithsej popullatë në komunën e Likovës sipas deklaratimit nacional , sipas regjistrimit të popullatës të RM-së të vitit 2002 .

Lloji i arsimit	Gjithsej
Doktor të shkencave	0
Magjistra	1
Arsim sipëror	74
Arsim të lartë	55
Arsim të mesëm	765
Arsim fillor	2996
Tjerë	224

c).Struktura e popullatës sipas arsimit në moshë deri 15 vite dhe më shumë vite, sipas regjistrimit të vitit 2002 .

Numri e njerëzve të vdekur në komunën e Likovës – sipas viteve				
2003	2004	2005	2006	2007
122	131	165	127	94

ç). Numri i ndryshimeve natyrore të popullatës / vjetor (rastet e vdekjes) .

Viti	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Aktiv	Diaspora	Shpërngu.	Anuluar	Të vdekur
2003	621	311	310	555	4	47	9	6
2004	614	311	303	561	9	37	5	2
2005	523	264	259	451	15	47	7	3
2006	532	275	257	479	2	46	3	2
2007	475	255	220	461	0	0	10	4

d) . numri e personave të posalindur në komunën e Likovës

Numri i veturave aktive në komunën e Likovës për vitin 2007 deri më 01.02.2008 është 3404 , kurse numri i automjeteve të regjistruar është 1877 Burimet e të

dhënaventi shtetëror statistikor I RM-së dhe ministria për Punë të Brendshme e RM-së – SPB Kumanovë

7. Infrastruktura

7.1. Banimi dhe planet urbanistike

Komuna e Likovës ka 5340 amvisëri (familje), me mesatare 5,06 anëtarë në familje. Akte të përgjithshme për planifikim urbanistik janë pregadit dhe aprovu nga kshiloli I komunes së Likovës me numer teknik 07-131/6 prej 30.03.2000 vitit, janë aprovue nga kshilli I Komunes së Likovës për: Vaksince, Slupcane, Orizare, Opaje, Likove, Otel, Ropalce, Vi[tice, dhe Naku[tak, za Per palnin general urbanistik per fshatin Likove me numer teknik 11/1998 prej marsit 1998 vitit, me periudhe te planifikuar prej 05.10.1999 deri me 05.10.2009 vitit. Për riemërtim si Plan urbanistik per Likoven, Kufiri per perfshirjen e planit urbanistik per fshatin Likove me siperfaqe prej 139,89 ha. për riemërtimin e Aktit të përgjithshëm në Plan urbanistik për vend

banimet: Vaksincë, Slupcanë, Opajë, Hotël, Vishticë, Ropalcë, Niku[tak, Matec

Dhe Lojan.

Aktet e përgjithshme për vendbanimet: Vaksincë, Slupcanë, Opajë, Hotë, Vishticë, dhe Ropalcë me numer teknik 07-131/6 të dates 30.03.2000. Akti I përgjithshëm për vendbanimin Nikushtak me numer teknik 07-129/3 të dates 18.05.2004 dhe aktet e përgjithshme për vendbanimet: Matecë dhe Lojanë me numer teknik 07-227/10 të dates 11.08.2005, riemërohen në PLANE URBANISTIKE PER FSHAT.

Kufiri I përfshirjes të planit urbanistik për fshatin Vaksincë është me siperfaqe prej _____ ha, Slupcani me siperfaqe prej 139,74 ha, Opaja me siperfaqe prej 66,76 ha, Hotla me siperfaqe prej 139,74 ha, Vishtica me siperfaqe prej 28,76 ha. Dhe Ropalca me siperfaqe prej 59,25 ha, Nikushtaku me siperfaqe prej 102,00 ha. Mateci me siperfaqe prej 134,10 ha, dhe Lojanio me siperfaqe prej 133,77 ha.

7.2. Ujësjellës dhe kanalizim

Njëri nga problemet më serioze në rajonin e komunës së Likovës është mungesa e ujit kualitativ për pije. Sistem për furnizim me ujë thuhet se nuk ka. Asnjë vendbanim në fshatra nuk është i furnizuar me ujë kualitativ dhe nuk ka rrjetë të ujësjellësit. Këtu popullata furnizohet me ujë përmes puseve individuale dhe burimeve të rajonit kodrinor – malor. Kjo do të thotë se fshatrat nuk janë të lidhur me sistem të ujësjellësit edhe ato që kanë e kanë vetëm parcialisht (vetëm një pjesë e fshatit e jo i tërë). Me rrjete të përkohshme me kualitet të dobët dhe me ujë jo kualitativ. Këso rrjete të ujit parciale jokualitative ka vetëm në 5 fshatra, në ato fushora, me përjashtim të fshatit Hotël, kurse fshatrat tjera nuk e kanë këtë.

Sidomos problematike janë ujërat që përdorin banorët në pjesën fushore, përshkak se janë të ndotur me arsen, antimon dhe krom dhe metale tjera të rënda, pastaj nga ujrat fekal (gropat septike) etj. Ato ujëra nuk kontrollohen nga institucionet sanitare dhe shëndetësore. Në komunën e Likovës edhe pse janë të ndërtruara dy liqej artificial për ujë të pijshëm dhe ujëtje me kapacitet deri 27 miliardë m³, prap, Likova nuk ka

sistem për furnizim me ujë për pije . Ky rezervuar e shërben Kumanovën dhe vendbanimet tjera . Qeveria ka dhënë leje për shfrytëzimin e ujit nga pendat , kurse sasia e shfrytëzimit është e kufizuar prej 25 l/sek., çka është e lejuar vetëmse për dy vendbanime, të Likovës dhe Orizares . Kjo pjesërisht shfrytëzohet edhe për ujitje të fushës nga teprica e ujit .

Si problem në komunën e Likovës janë ujërat e zeza (sistemi i kanalizimit nuk ekziston) , të cilat janë me bakterie dhe të tjera gjëra helmuese dhe i ndotin ujrat nëntokësor , përkatësishtë burimet (bunaret) , shtresat tokësore , oborret etj .

8. PUSHTETI KOMUNAL NË LIKOVË

8.1. Kryetari

Kryetari zgjedhet në zgjedhje të drejtpërdrejta me mandate prej 4 viteve . Kryetari i tanishëm është profesor i edukatës fizike .

Kryetari i përfaqëson dhe prezenton intereset e komunës . Për punën e vet kryetari është përgjegjës para qytetarëve të komunës së Likovës .

Kryetari në kuadër të kompetencave të tija :

- inicion dhe propozon sjellje të dispozitave nga kompetenca e Këshillit të komunës ;
- i siguron kryerjen e punëve të cilat janë të deleguara nga organi i drejtorisë shtetërore ;
- e propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës ;
- e kryen buxhetin e komunës ;
- vendos për punë juridike , obligime dhe interese të personave juridik dhe fizik, në pajtim me ligjin ;
- udhëheq me administratën e komunës ;
- sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale ;
- vendos për punësime , të drejtat , kompetencat dhe përgjegjësit për të punësuarit në administratën komunale , nëse ndryshe nuk është e përcaktuar me ligj ;
- zgjedh drejtor të shërbimeve publike që i ka themeluar komuna , në bazë të konkursit publik ;
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me statut .

Kryetari i komunës së Likovës mund të autorizojë udhëheqës zyrtar të komunës të ngrejë procedurë dhe të vendosë në punët drejtuese , si dhe të nëshkruajë akte .

8.2. Këshilli i komunës

Anëtarët e këshillit të komunës i zgjedhin qytetarët në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të pavarura me mandate prej katër viteve.Këshilli i komunës është trup për sjelljen e vendimeve .

Këshilli i Komunës së Likovës ka 19 anëtarë të zgjedhur.Kryetar i tanishëm i këshillit është z.Skender Muslija .

Mandati i anëtarëve të këshillit zgjatë 4 vite .

Këshilli i komunës i kryen këto punë :

- 1.Sjell statutin e komunës .
- 2.Sjell rregulloren e këshillit .
- 3.Sjellë programin për punë .

4. Sjell buxhetin e komunës dhe llogarinë përfundimtare .
5. E përcakton lartësinë e shkallës për tatimet dhe lartësinë e kompensimeve dhe taksave .
- 6.Sjell planin gjeneral urbanistik .
- 7.Sjell planin detaj urbanistik dhe dokumentacionin urbanistik për vendbanimet në komunë .
- 8.Sjell program për rregullimin e tokës ndërtimore .
- 9.Sjell program për mirëmbajtjen e sinjaleve të komunikacionit .
10. Sjell vendim për rregullimin e regjimit të komunikacionit .
11. Sjell dispozita nga fusha e e mbrotjes të ambientit jetësor dhe natyrës , zhvillimit lokal e konomik , kulturës , sportit dhe rekreacionit , mbrotjes sociale të fëmijëve , në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj të veçantë ose në pajtim me programën nacionale .
12. Sjell program për punimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave .
13. Sjell program për ndriçimin publik .
- 14.Sjell program për ndërtim , rekonstruim dhe mirëmbajtje të ujësjellësit lokal .
- 15.Sjell program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike .
- 16.Sjellë program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e e parqeve dhe sipërfaqeve tjera publike nga rëndësia lokale .
17. Sjell program për mirëmbajtjen e varrezave .
18. Sjellë program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e lumejve në rajonet e urbanizuara .
- 19.Sjell vendim për pastërtinë publike .
20. Sjellë vendim për mënyrën e transportit në trafikun urban dhe ndërrurban .
21. Sjellë vendim për mirëmbajtje dhe shfrytëzim të tregjeve publike .
- 22.Sjellë vendim për mënyrën e përdorimit dhe shfrytëzimit të varrezave .
- 23.E rregullon mënyrën e pastrimit të oxhaqeve .
24. E rregullon mirëmbajtjen e hapësirave publike për parkim dhe mënyrë e shfrytëzimit të tyre .
25. Përcakton emra të rrugëve , shesheve ,urave dhe objekteve tjerë të infrastrukturës nga rëndësia lokale .
26. E përcakton organizimin , sferë veprimin dhe mënyrën e kryerjes të detyrave të administratës komunale , me propozim të kryetarit .
27. Themelon shërbime publike dhe kryen mbikëqyrje mbi punën e tyre.
28. Emron anëtarë të Këshillave drejtuese të shërbimeve publike , të cilat i themelon .
- 29.Miraton program për punë dhe plane financiare për financimin e shërbimeve publike të cialt i ka themeluar .
30. Vendos për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarisë nga interesi publikë nga rëndësia lokale në pajtim me ligjin .
- 31.I miraton raportet për punën dhe llogarinë përfundimtare të shërbimeve publike të cilët i ka miratuar .
32. Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës .
33. Vendos për mënyrën e kryerjes të kontrollës financiare të buxhetit të komunës , në pajtim me ligjin .

34. I zgjedh personat të cilët do të udhëheqin me njësitë rajonale të Ministrisë së punëve të brendshme në komunë , në pajtim me ligjin .

35.E shqyrton dhe miraton raportin vjetor për siguri publike në rajonin e komunës së Likovës , të cilin e dorëzon deri te Ministria e Punëve të Brendëshme dhe Avokati i Popullit .

36. Mund të japë sugjerime personave udhëheqës të njësive rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendëshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë në trafik .

37. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e këshillit .

38. Formon komisione të përhershme dhe të përkohëshme.

39. Kryen kompetenca të veçanta në pajtim me Ligjin , mbi të mirat nga nevojat e përgjithshëm dhe mbi pasuritë natyrore në rajonin e komunës .

40. Ndanë mirënjohje dhe dhurata komunale .

41. Jep mendim për propozim ligjet të cilët i përkasin komunës .

42. Kryen zgjedhje tjera dhe emrime nga kompetenca e vet .

43. Sjellë edhe akte tjera për punë nga kompetenca e vet .

44. Kryen edhe punë tjera .

8.3.Këshilli i Komunës së Likovës i ka këto komisione :

- komisioni për financim , buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal ;

-Komisioni për urbanizëm,shërbime komunale,mrojtje të mjedisit jetësor.

- komisioni për veprimtari shoqërore ;

- komisioni për statut dhe dispozita ;

- komisioni për çështje mandatare , zgjedhje dhe emrime

Përveç komisionit për për çështje mandatare , zgjedhje dhe emrime i cili është i përbërë nga 5 veta të këshillit , të tjerat komisione janë të përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët 3 anëtarë janë anëtarë të këshillit dhe 2 të jashtëm .

9. Administrata komunale

Me të vetmin qëllim për informim sa më të mirë të qytetarëve të komunës së Likovës , si dhe administratë efikase dhe kualitative e shërbimeve , si dhe transparente në punën komunale të nëpunësve shtetëror .

10. Karakteristikat ekonomike

Duke shikuar potencialin ekonomik lokal që kanë në dispozicion kapacitetet ekonomike , komuna e Likovës numërohet në kategoritë e komunave të pazhvilluara . Në këtë moment degë më të zhvilluara ekonomike janë : industria e mullinjëve , industria e prodhimit të mobiljeve dhe zdrukthtaria .

Sipas të dhënave nga Enti shtetëror statistikor deri më datën 31.12.2005 në evidencën e subjekteve afariste janë regjistruar gjithsej 868 , por një pjesë e madhe e tyre janë joaktive .

Nga ato 37% janë ndërmarrje , 56% janë shoqata tregëtare dhe 7% janë të tjerat (organe të administratës shtetërore , njësia e vetadministrimit lokal , partitë politike , shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet etj.).

Ndërmarrje	Shoqata tregëtare	Të tjera	Gjithsej
324	488	56	868

Numri i subjekteve sipas llojeve të Entit shtetëror statistikor të dt.31.12.2005 .

Subjektet afariste sipas sektorëve të veprimtarisë	Gjithsej
--	----------

Ndërmarrjet	324
Shoqatat tregtare	488
Të tjerat (shoqatat , institucionet dhe organizatat)	56
Bujqësia , gjuetia dhe pylltaria	22
Industria përpunuese	80
Furnizimi me energji elektrike , gaz dhe ujë	1
Ndërtimtaria	21
Tregtia e madhe dhe e vogël	542
Hotele restaurant	21
Komunikacioni dhe lidhjet	108
Arsimi	6
Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	16

Numri i subjekteve afariste sipas sektorëve të veprimtarisë sipas Entit shtetëror statistikor të dt 31.12.2005 .

Përshkrim	Numri i të punësuarve në komunën e Likovës
Meshkuj	
Femra	
Gjithsej	

Të dhëna nga burimet : Enti shtetëror statistikor i RM-së .

Numri më i madhë i të punësuarve ka te obliguesit me më shumë se 25 sigurues , ndërsa numri më i vogël është te obliguesit me 6-10 të punësuar .

Përshkrim	Nr. i obliguesve	Numri i të punësuarve
Obliguesit më pak se 5 të punësuar		
Obliguesit me 6-10 të punësuar		
Obliguesit me 11-25 të punësuar		
Obliguesit më shumë se 25 punësu.		

Obliguesit me numër të personave të punësuar .

10.1. Bujqësia

Në komunën e Likovës , degë tradicionale ekonomike është bujqësia , përshkakse ekzistojnë kushtete të mira natyrore dhe kushte agroteknike për zhvillim të saj , toka është pjellore dhe në pjesën më të madhe të sinorit të fshatrave është tokë punuese , e cila ujitet nga ujrat e sistemit të Likovës .

Sipas të dhënave nga Enti statistikor shtetëror I RM , nga regjistrimi të bujqësive në komunën e Likovës ka 2 veprimtari bujqësore edhe atë bujqë individual 3450 , të cilët disponojnë me gjithsej sipërfaqe prej 8256 ha ose 36% bie në tokë punuese .

Familjet që disponojnë pyje janë _____

Sipas të dhënave të njësive rajonale të ministrisë për bujqësi pronë punuese është _____ ha , nga e cila është dhënë në shfrytëzim rreth _____ ha .

10.2. Industria e drurit

Për ekonomizim me pyjet në komunën e Likovës kompetente është ndërrmarja publike për ekonomizim me pyje „ Kumanovë “ , nga Kumanova . Zhvillimi i industrisë së drurit shkonë përpjetë , disa firma kanë reparte për prodhime të mobiljeve të cilat janë të orientuara për tregun e brendëshëm .

Në komunën e Likovës ekziston një punishte dërrasash për ndërtimtari .

10.3. Papunësia

Në evidencën e qendrës për punësim në Kumanovë prej 01.01.2008 ka të regjistruar gjithsej _____ persona .

Përshkrim	JOKUAL	GJKUAL	KUAL	AM	AL	AS	Magjistra
Meshkuj							
Femra							
Gjithsej							

Numri i të papunësuarve sipas shkallës të arsimimit .

Përshkrim	Deri 30 vite	30-40	40-50	Mbi 50
Meshkuj				
Femra				
Gjithsej				

Numri i të punësuarve sipas moshës .

Përshkrim	Shqiptarë	Maqedon	Sërb	Të tjerë
Meshkuj				
Femra				
Gjithsej				

Numri i të punësuarve sipas strukturës nacionale .

Nga gjithsej numri i përgjithshëm I të papunëve (_____) , vetëm përshkak të sigurimit shëndetësor janë evidentuar (_____) , çka do të thotë se të tjerët prej _____ persona të papunësuar aktivë kërkojnë punë .

11. Mbrojta sociale

Në komunën e Likovës nuk ekziston qendër për mbrojtje sociale , shfrytëzohet qendra e komunës së Kumanovës , e cila financohet nga Ministria për punë dhe politikë sociale , pranë qeverisë së Maqedonisë .

Nga fusha e mbrojtjes të fëmijëve si institucion publik komunal nuk ka komuna e Likovës .

Prej 2006 ndërprehet grupet e foshnjorëve në moshë gjashtë vjeçare të fëmijëve , si në kopshtet e fëmijëve dhe në shkollat fillore në pajtim me ligjin , ato bëhen pjesë të arsimit fillor të detyrueshëm në mësim përgatitor .

11.1 Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në territorin e komunës së Likovës qytetarët mund t'i marrin përmes institucioneve shëndetësore private . Në komunën e Likovës nuk ka institucione publike shëndetësore .

11.2 Arsimi

Arsimi në komunën e Likovës është i organizuar në 6 qendra shkollore dhe 11 periferike nga mësimi i rregullt i detyrueshëm . Numri i përgjithshëm i nxënësve , paraleleve dhe arsimtarëve për vitin shkollor 2003/2004 , 2004/2005 , 2005/2006 , 2006/2007 dhe 2007/2008 .

Arsimi i mesëm është i organizuar në paralele të ndara nga shkolla e mesme komunale „ Goce Dellçev “ –Kumanovë dhe shkollë e mesme komunale „Kiro Burnaz” – Kumanovë , me numër të përgjithshëm të nxënësve , paraleleve dhe arsimtarëve për vitin shkollor 2003/2004 , 2004/2005 , 2005/2006 , 2006/2007 dhe 2007/2008 .

Të dhënat për numrin e nxënësve është variabil dhe ka trend të ramjes përshkak të numrit të madhë të të shpërngulurve të shumë familjeve në shtetet e Evropës , migracioni fshat qytet , si dhe përshkak ramjes të natalitetit .

Në vord pasqyrat e tabelarëve të punuar për shkollat e mesme dhe fillore .

12.Kultura

12.1 Bibliotekë

Në komunën e Likovës nuk asnjë institucion publik komunal- bibliotekë . Në disa shkolla qendrore fillore ka biblioteka me një numër të konsiderueshëm të librave, e nuk kanë mësimore për lexim .

12.2 Shtëpia e kulturës

Në fshatin Mateç kishte shtëpi të kulturës , pas konfliktit luftarak në vitin 2001 tërësisht është shkatërruar .Në vitin 2007 është përgatitur proekti teknik nga komuna e për shtëpi kulture në Mateç . Në vitin 2007 janë ndarë 3.000.000 den. nga Ministria e kulturës dhe më vitin 2008 janë ndarë 8.000.000 den. dhe mendoj se do të ndërtohet shtëpi e kulturës e cial do t'i plotësojë nevojat e qytetarëve .

12.2 Sport

Në aktivitetet sportive futballi udhëheq me historinë e tij të gjatë . Skuadra e parë e futballit është formuar më vitin _____ , me emrin _____.

Skuadrat sportive në komunën e Likovës janë :

- Lidhja komunale e futbollit
- KF „Besa “,fsh.Sllupçan
- KF „Mateçi “, fsh. Mateç
- K.F. Vëllezërimi “,fsh.Orizare
- K.F. „ Likovë “, fsh.Likovë
- K.F. „ Opajë “ , fsh.Opajë
- Terene sportive për futboll të vogël .

13. Mbrojtja e ambientit jetësor

Plani aksionar lokal për mjedis jetësor (LEAP) për komunën e Likovës është sjellur më vitin 2004 dhe ka për qëllim të ballafaqohet jo vetëm me mjedisin jetësor , por edhe me çështjet për shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve , si dhe me problemet sociale dhe ekonomike .

Krijimi dhe zbatimi i LEAP-it është shenjë se pushteti lokal e merrë përgjegjësitë kujdesin për mjedisin jetësor dhe i zgjedh prioritetet për mbrojtje të mjedidit jetësor .

13.1 Menaxhimi me hedhurinat

Në komunë e Likovës hedhurinat grumbullohen në mënyrë të organizuar nga ana e ndërmarrjes publike për pastrim dhe gjelbërim „Pisha “ , fsh.Orizare , për kryerjen e veprimtarive komunale nga interesi i publikë dhe i përgjithshëm . Edhe pse hedhurinat grumbullohen në mënyrë të organizuar hedhurinat prap janë shumë të gjuajtur nëpër oborre , ara , djegën ose gjuhen në sipërfaqet publike ose shtretërit e lumejëve .

Komuna nuk deponi të posaçme për kafshët e ngordhura , kështu që deponimi dhe ngordhja e kafshëve bëhet në sipërfaqet publike ose i djegin .

Në lidhje me hedhurinat medicinale deponohet njësoj në deponin ekzistuese për hedhurina në komunë .

13.2 Shoqata e qytetarëve , asociacionet

Komuna e Likovës në veçanti i jep përkrahje OJQ , sektori shoqatat aktive të qytetarëve me sa vijon :

Asociacionet sportive :

- Lidhja komunale e futbollit
- Klubi i Futbollit „Besa “
- Klubi i Futbollit „ Vëllezërimi “
- Klubi i Futbollit „ Mateçi”
- Shoqata e gjuetarëve „ Fauna “
- Shoqata e gjuetarëve „ Shqiponja “

Asociacionet sociale

- Shoqata ekologjike „Natyra “
- Shoqata „Baran “
- Shoqata „ Jeta “
- Lidhja e gruas shqiptare në Maqedoni , dega –Likovë
- SHKA „Jeta e re “, fsh.Sllupçan

Asociacione bujqësore

- Shoqata e bujqëve „ Agrokultura “

14. Shërbime

Transporti lokal në komunën e Likovës është i organizuar me taksi furgona dhe me transport auto-taxi .

Në komunën e Likovës me vendim të Këshillit të komunës janë të caktuar lokacionet për vetura taxi . Në çdo vendbanim lokacionet janë të caktuara me qëllim që të transportojnë i afrojnë sa më afër qytetarëve .

Licenca për transport auto-taxi në komunë kanë _____ vetura .Ato jepen nga ana e kryetarit të komunës së Likovës , me afat vazhdimi prej 2 viteve , për të cilën udhëhiqet regjistër nga ana e komunës .

14.1 Tregëtia

Në komunën e Likovës në të gjithë vendbanimet punojnë një numër i madhë i marketeve –shitoreve furnizimi i të cilave i plotësojnë nevojat e harxhuesve .Gjithashtu punojnë punëtori (mekanik , auto-ngjyrosës , zdruckhtari etj.).

14.2. Mediumet , komunikimi

Mediumet lokale janë këto Radio Jehona 2003 në fsh.Mateç , Kosmofon , Mobimak , Vip ,Frog , Makedonski telekomunikaci etj.

15. Kualiteti i jetesës

Komuna e Likovës është e pasur me bukuri natyrore . Si vende turistike figurojnë liqeni i Likovës, Manastiri –pushimorja në fsh.Mateç .

Në komunën e Likovës ka një numër të madhë të duqaneve , butiqeve , çajtove , kafiterive dhe restaurantëve , ku qytetarët mund t’a kalojnë kohën e lirë .

Shkollat Filllore	2003/2004			2004/2005			2005/2006			2006/2007			2007/2008		
	Nxën ës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë
Kultura	1006	48	46	1040	48	52	1051	45	53	1410	56	71	1410	59	78
A.Z.Çajupi	569	19	26	560	19	26	561	19	26	558	20	27	568	21	28
Ditura	652	33	55	658	33	55	660	33	55	647	33	56	621	33	60
F.Konica	1099	43	50	1114	44	54	1487	64	77	1478	64	77	1108	47	57
Rilindja	769	32	38	770	32	40	748	32	40	769	32	40	769	32	47
7 Marsi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	376	18	22
Gjithsej	4095	175	215	4142	176	217	4507	196	251	4802	205	271	4852	214	292

Pasqyra e numrit të përgjithshëm të nxënësve , paraleleve dhe arsimtarëve në shkollat qendrore të kmunës së Likovës .

Shkollat e mesme	2003/2004			2004/2005			2005/2006			2006/2007			2007/2008		
	Nxën ës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë	Nxë nës	Para lele	Arsim tarë
Goce Dellçev	346	10	23	365	11	24	381	12	29	380	12	29	412	13	32
Kiro Burnaz	133	5	15	108	4	14	115	5	15	110	5	15	120	5	15
Nace Bugjoni	139	/	/	164	/	/	288	/	/	288	/	/	371	/	/
Gjithsej :	618	15	38	637	15	38	729	17	44	778	17	45	903	18	47

Pasqyra e numrit të përgjithshëm të nxënësve , paraleleve dhe arsimtarëve në SHMK gjimnazi „Goce Dellçev “ - Kumanovë , SHMK „Kiro Burnaz “-Kuamnovë (paralelele të ndara të komunës së Likovës) dhe SHMK „Nace Bugjoni “ nga Kumanova (nxënësit e komunës së Likovës) .